



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0274

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga **XX** duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Limit L & B SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontrate të Komunës Suharekës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave" me numër të prokurimit 624-22-12145-2-2-1, me 12/06/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e pjesërisht e bazuar ankesa e OE Limit L & B SH.P.K. me nr. 2023/0274, e datës 15/05/2023, kurse vendimi i AK Komunës Suharekës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave" me numër të prokurimit 624-22-12145-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik . Limit L & B SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.04.2023, AK – Komuna Suharekës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka shpërblyer me kontratë Grupin e Operatorëve ekonomik Sinjalizimi sh.p.k, Cube Designers L.L.C për aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave” me numër të prokurimit 624-22-12145-2-2-1.

Me datën 02.05.2023 Operatori ekonomik ankues Limit L & B SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. AK - Komuna Suharekës me datën 05.05.2023 ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik.

I pakënaqur me vendimin e AK, me datën 15.05.2023 Operatori ekonomik Limit L & B SH.P.K, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0274, kundër B58 Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Lloji i kontratës: shërbime, Vlera e parashikuar e kontratës: 50,000.00 €.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu edhe nenit 108/A të ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie në kompetencat e tij në kuptim të nenit 105 të LPP.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 19.05.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të aprovet si pjesërisht e bazuar- të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër përmban elementet qenësore dhe i njëjti i është dërguar autoritetit kontraktues dhe ankuesit. Lidhur me këtë raport të ekspertizës AK është pajtuar me mendimin e ekspertit ndërsa Operatori ekonomik ankues nuk ka shprehur mendimin rreth raportit të ekspertit.

Përgjigje në Pretendimet Ankimore të OE ankues Limit L & B SH.P.K

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin në këtë aktivitet të prokurimit të operatorit ekonomik ankues, se ne nuk e kemi theksuar se nuk ka LISTE TE STAFIT!!!!? Ne edhe një here po theksojmë se Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka asnjë punëtorë të lajmëruare në ATK. Meqenëse i mungon kjo dëshmi ky GOE është dashur të prezantoi Kontratën me punëtorë për këtë PROJEKT: me nr. p.r. 624-22-12145-2-2- 1 dhe titull: Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i

adresave. KONTRATAT e ofruara janë të përgjithshme dhe nuk thirren në Projekt, janë të pa vlera. Këto Kontrata të përgjithshme do të kishin validitet vetëm nëse kemi stafin në ATK.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së, si në vijim:

Kërkesat: Kërkesa 2 - OE duhet të prezantoj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt, min. (5) pesë punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e projektit.	Evidencat: Dëshmia 2 - Lista e punëtorëve duhet të përmbajë këto të dhëna Emri, (vite) dhe pozicioni në kompani – e nënshkruar dhe e vëlosur nga Operatori. Kontrata e punës apo Parakontrata e punës e nënshkruar nga Punëdhënësi, të dorëzohet në kopje.
---	--

GOE i rekomanduar për dhënie të kontratës lideri i grupit “Sinjalizimi” Sh.p.k., ka dorëzuar listën e stafit të nënshkruar dhe të vëlosur me gjithsejtë 11 punëtorë, duke i bashkangjitur kontratat e punës të nënshkruar dhe të vëlosura *(tek dëshmia e kërkuar nuk është specifikuar se kontrata duhet të ketë edhe titullin dhe numrin e prokurimit, por vetë fakti se OE ka dorëzuar listën nënkuptohet se këta punëtorë do të angazhohen për këtë projekt/kontratë)*, prandaj duke marrë për bazë kërkesën e FDT-së si më lartë, AK nuk ka specifikuar se kontratat duhet të jenë në emër të këtij projekti (titullin dhe numrin e prokurimit) si dhe nuk ka qenë kërkesë se këta punëtorë duhet të jenë të lajmëruar në ATK, pasi që OE kanë pas mundësi të ofertojnë edhe para kontratave për punëtorë. Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimin nr. 2

Lidhur me pretendimin në këtë aktivitet të prokurimit të operatorit ekonomik ankues, se ne kemi theksua dhe theksojmë se GOE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur sepse Udhëheqësi i punishtes nuk ka ofruar dëshmi se ka udhëhequr se paku një projekt të sinjalizimit vertikal dhe horizontal, pra nuk dëshmohet ashtu si qeshte kërkuar nga vet AK-ja. Po ashtu nuk është ofruar asnjë dëshmi konkrete se ky udhëheqës i punishtes që ka 2 vite përvojë të punës profesionale. Ekziston diploma, kontrata e CV por jo dëshmitë e kërkuara. Pra edhe në këtë pikë i rekomanduari për kontratë është i papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së, si në vijim:

Kërkesat:

Kërkesa 3 - Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme dhe atë

a) Menaxheri - i projektit duhet të jetë ing. i dip. Makinerisë, drejtimi komunikacionit me min. 2 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit). Duhet te ketë menaxhuar se paku një (1) kontrata te natyrës se ngjashme.

b) Udhëheqës i punishtes bachelor I Komunikacionit me se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit). Duhet te ketë udhëhequr se paku një (1) kontrata te natyrës se ngjashme.

Evidencat:

Dëshmia 3 - Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe e vulosur. Listës duhet ti bashkëngjiten këto dëshmi - Diploma kopje; CV-ja kopje e nënshkruar; Referencat ; - Kontrata e punës apo Para kontrata e punës e nënshkruar dhe e vulosur nga Punëmarrësi dhe Punëdhënësi, dhe -Vendimi I nënshkruar dhe I vulosur nga përfaqësuesi I OE për emërimin e menaxherit dhe udhëheqësit të punishtes te kontratës sipas kërkesave ne pikat a) dhe b).

GOE i rekomanduar për dhënie te kontratës lideri i grupit “Sinjalizimi” Sh.p.k., ka dorëzuar udhëheqësin e punishtes duke dorëzuar para kontratën, diplomën dhe CV-ne, OE ankues lidhur me këtë pretendim nuk ka specifikuar saktë se çka nuk plotësohet kjo kërkesë, por thotë: “ nuk është ofruar asnjë dëshmi konkrete se ky udhëheqës i punishtes qe ka 2 vite përvojë te punës profesionale”, sepse referuar CV-se te udhëheqësit të punishtes tek përvoja profesionale është si në vijim

Përvoja profesionale	5 vite
Data	23.07.2007-01.07.2009
Pozita e mbajtur	Inxhinier i punimeve
Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë	➤ Udhëheqjen e punimeve në Ndërtimin e infrastruktures kablore ne objektet e reja ne Prishtine
Emri dhe adresa e punëdhënësit	NNT „HIDROTERM” Suhareke
Lloji i organizatës, biznesit	Ndërmarrje Ndërtimore Tregtare
Data	01.06.2009 deri tani
Pozita e mbajtur	Menagjer i projekteve
Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë	➤ Udhëheqjen e punimeve në Ndërtimin e infrastruktures kablore ne objektet e reja ne Prishtine ➤ Udhëheqjen e punimeve në projektin „shtrirjen e kablilit optic Suhareke-Prizren” ➤ Udhëheqjen e punimeve në projektin „shtrirjen e kablilit optic Prizren-Vernice”
Emri dhe adresa e punëdhënësit	NNSH „Ascom” Suhareke
Lloji i organizatës, biznesit	Ndërmarrje Ndërtimore Shërbyese,,
Data	31.10.2012 deri me tani
Pozita e mbajtur	
Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë	➤ Ekspert gjyqesore ne lemin e komunikacionit rrugor” ➤ Analizen, konstantimi dhe mendimi i ekspertizes
Emri dhe adresa e punëdhënësit	Gjykata e Qarkut në Prizren

Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës se mësipërme si dhe pretendimin e OE ankues lidhur me këtë pikë i cili nuk është sqaruar në mënyrë specifike dhe konkrete *(pasi qe bazuar ne CV-ne si me larte përvoja e punës lidhur me udhëheqjen e projekteve te ngjashme ekziston, si dhe referencat nuk janë kërkuar, prandaj është e pamundur te jap vlerësim tjetër me pretendimin e ngritur nga OE ankues)* prandaj, vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këto pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin në këtë aktivitet të prokurimit të operatorit ekonomik ankues, se po theksojmë se GOE i rekomanduar për kontratë ka ofruar marrëveshje me kompaninë “Globbus Group” për RAMPA -LAURA, duke u thirr se është distributor i “NICE” Itali, por është RELEVANTE se kompania “NICE” <https://www.niceforyou.com/en/wide-barrier-system> nuk është prodhuese e bollardsave-pistonave hidraulik-shtylla zhytëse.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së, si në vijim:

Kërkesat: Kërkesa 4 - Marrëveshje me prodhuesin e rampave, apo distributorin e autorizuar të prodhuesit.	Evidencat: Dëshmia 4 - Marrëveshja me prodhuesin rampave, apo distributorin e autorizuar të prodhuesit të bollardsave-pistonave hidraulik.
--	--

GOE i rekomanduar për dhënie të kontratës lideri i grupit “Sinjalizimi” Sh.p.k ka dorëzuar marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë “Globbus Group” Sh.p.k. si distributor i ai autorizuar nga prodhuesi NICE për furnizim dhe montim me rampa, si dhe certifikata e lëshuar nga NICE se “Globbus Group” Sh.p.k. është distributore për territorin e Kosovës. Prandaj nëse e analizojmë kërkesën 4/dëshminë 4 të FDT-së si me lartë, atëherë vërehet se në kërkesë është kërkuar vetëm rampa - marrëveshja me prodhuesin/distributorin, ndërsa tek dëshmia është shtuar apo distributorin e autorizuar të prodhuesit të bollardsave-pistonave hidraulik, prandaj bazuar në dokumentet e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën dhe dëshminë të përcaktuar në FDT (*sepse dëshmia është rampa apo bollardsave-pistonave hidraulik, kurse në kërkesë është kërkuar vetëm rampa, ka një mospërputhje mes kërkesës dhe dëshmisë*). Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojmë se pretendimi i palës në ankese në këto pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin në këtë aktivitet të prokurimit të operatorit ekonomik ankues, se GOE i rekomanduar për kontratë i mungon marrëveshja me prodhuesin apo distributorin e gypave-shtyllave të zinkuara, e cila nuk e plotëson kërkesën e 6 ku është kërkuar “Marrëveshje me prodhuesin apo distributorin e autorizuar të prodhuesit të shtyllave metalike të zinkuara (për shtyllat e shenjave të komunikacionit)”.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së, si në vijim:

Kërkesat:

Kërkesa 6 - Marrëveshje me prodhuesin apo distributorin e autorizuar të prodhuesit të shtyllave metalike të zinkuara (për shtyllat e shenjave të komunikacionit)

Evidencat:

Dëshmia 6 - Marrëveshje me prodhuesin apo distributorin e autorizuar të prodhuesit të shtyllave metalike të zinkuara (për shtyllat e shenjave të komunikacionit).

GOE i rekomanduar për dhënie të kontratës lideri i grupit “Sinjalizimi” Sh.p.k ka dorëzuar disa Mill test EN 10204/2.2 - Test Raport N°. 2418, dhe 2416 - Deklaration of compliance, me Contrat N° S235JRH (ky kod ka kuptimin: *Square Steel Pipes Manufactures = Sheshi i tubave çeliku prodhon*) të datës 23.09.2026, si dhe duke marr për bazë këtë test raport dhe certifikatën e biznesit të liderit të grupit “Sinjalizimi” Sh.p.k. ku aktivitet kryesorë i biznesit është: Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre, me kod 2511, Prandaj, nëse merret për bazë kërkesën e dosjes së tenderit si më lart, atëherë konsideroj se AK ka mund të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, (në mënyrë që të sigurohet se GOE e plotëson këtë kërkesë të FDT-së). Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, nuk ka respektuar nenin 7, 59, dhe 72 të LPP-së, andaj, Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së, në këtë aktivitet të prokurimit, në mënyrë që të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 në dosje të tenderit si dhe të respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

-Mendimi i ekspertit shqyrtues-

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura dhe pretendimet ankimore të lartcekura eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet si më lartë) dhe rekomandon që të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK (vendimit për dhënie të kontratës) dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP,

përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre, ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e palëve në proces, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - . Limit L & B SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: